

NJOFTIM PËR MEDIAN

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), në datën 21.09.2019, zhvilloi mbledhjen me këtë rend dite :

1. Diskutimi dhe miratimi i Listave Përfundimtare të Renditjes së Kandidaturave për 4 vende vakante në Gjykatën Kushtetuese, si edhe i raporteve përkatës të kësaj renditjeje.
2. Shpallja e fillimit të procedurës së verifikimit të kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019, si edhe zhvillimi i procedurës së shortit për përcaktimin e relatorit të këtij vendi vakant
3. Diskutim për ecurinë e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe numrin e kandidatëve të mbetur për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr. 10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

Në përfundim të diskutimit të çështjeve, në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e Raportit të arsyetuar dhe të Listës Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, me renditjen si më poshtë :

- 1) Arta Vorpsi 89.642 Pikë
- 2) Elsa Toska 85.428 Pikë
- 3) Besnik Muçi 81.928 Pikë
- 4) Regleta Panajoti 80.285 Pikë

2. Miratimin e Raportit të arsyetuar dhe të Listës Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 12.02.2018, me renditjen si më poshtë :

- 1) Arta Vorpsi 89.642 Pikë
- 2) Elsa Toska 85.428 Pikë
- 3) Besnik Muçi 81.928 Pikë.

3. Miratimin e Raportit të arsyetuar dhe të Listës Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, me renditjen si më poshtë :

- 1) Arta Vorpsi 89.642 Pikë
- 2) Fiona Papajorgji 88.785 Pikë
- 3) Elsa Toska 85.428 Pikë
- 4) Marsida Xhaferllari 82.000 Pikë

4. Miratimin e Raportit të arsyetuar dhe të Listës Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019, me renditjen si më poshtë :

- 1) Arta Vorpsi 89.642 Pikë
- 2) Fiona Papajorgji 88.785 Pikë
- 3) Elsa Toska 85.428 Pikë

Vendimet për vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat, vendimet për miratimin e listave përfundimtare të renditjes së kandidatëve, si edhe raportet e arsyetuar për renditjen e tyre në secilin vend vakant, do të bëhen publike menjëherë pas reflektimit në këto akte të vërejtjeve dhe sugjerimeve të kësaj mbledhjeje të KED-së, për të vijuar me dërgimin e tyre dhe të dokumentacionit përkatës të kandidaturave pranë Presidentit të Republikës dhe Kuvendit, për ushtrimin sipas Kushtetutës dhe ligjit të kompetencave dhe përgjegjësisë të emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019.

2. Zhvillimin e shortit për caktimin e anëtarit relator të KED-së në procesin e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019. Ky short, u vendos të zhvillohej në mënyrë manuale, sipas dispozitave në fuqi, për shkak të pamundësisë teknike të zhvillimit të tij në mënyrë elektronike.

- Sipas rezultatit të shortit, zoti Fatri Islamaj caktohet anëtar /relator.

- Anëtari relator do të mbështetet nga këshilltarët e Gjykatës së Lartë posaçërisht të ngarkuar me detyra pranë KED-së. Për qëllime të ndarjes së ngarkesës së punës, këshilltarët do të kryejnë detyrat e tyre në lidhje me kandidatët e caktuar, sipas rezultatit vijues të shortit:

- Këshilltari Saimir Nazifi në lidhje me kandidatët Ded Kasneci dhe Regleta Panajoti.

- Këshilltari Florian Kalaja në lidhje me kandidatët Ardita Alsula (Buna) dhe Shaqir Hasani.

- Këshilltari Besmir Rrapaj në lidhje me kandidatët Klodian Rado dhe Vjosa Bodo (Mujo).

Në lidhje me pikën e tretë të rendit të ditës, për shkak se në përfundim të rishqyrtimit të gjetjeve në procedurën e verifikimit, në mbledhjen e datës 09.09.2010 u vendos ndalimi i kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto, duke qenë se në konkurrim mbeten më pak se tre kandidatë të lejuar, Këshilli vendosi:

- Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr. 10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

Zyra e Shtypit

Tel/Fax:04227806

<http://www.gjkataelarte.gov.al>